

# 17 NGJARJE HISTORIKE QË

## PRODHUAN 17 SHKURTIN



Pavarësia e Republikës së Kosovës është një rrugëtim i gjatë që në vete përmban një zhvillim dinamik të historisë, me theks të veçantë historisë nga viti 1913 e këndej. Pavarësia e Kosovës aq sa është zhvillim i nivelit politik, përmban në brendësi e saj edhe një mori ngjarjesh që formësojnë historinë sociale të këtij vendi. Ndryshimet gjeopolitike të cilat erdhën si rezultat i punimeve të Konferencës së Ambasadorëve, patën parasysh në fokus të ngushtë rezultatet pas Luftës së Parë Ballkanike dhe duket se neglizhuan dimensionin e konflikteve politike e shoqërore që kishin zënë vend në truallin ballkanik para kësaj lufte. Përcaktimi arbitrar i kufijve të rinj, mohoi në masë të madhe, “Të drejtën e vetëvendosjes”, që deri në atë kohë ishte formësuar nga ngjarjet e mëdha si Revolucioni Amerikan dhe Francez. Pozicioni politik nuk ndryshoi edhe pas promovimit të kësaj të drejte, si bazë për paqen e qëndrueshme në botë, nga presidenti Wilson. Me aneksimin zyrtar të Kosovës nga Mbretëria Serbo-Kroate dhe Sllovene, pozicioni i Kosovës u vështirësua si rezultat i mungesës së autonomisë brenda kësaj mbretërie si dhe mohimi i plotë i të drejtave bazike të popullit të Kosovës. Në këtë periudhë, u theksuan tentativat institucionale për të ndryshuar strukturën etnike të popullsisë së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe në Kosovë, u vendosën rreth 13,000 familje serbe dhe malazez. Në periudhën e Luftës së Parë Ballkanike është vlerësuar të jenë dëbuar 281,747 njerëz. Në mes periudhës 1912-1941, sipas statistikave janë vendosur rreth 60-65000 kolonë. Për kolonët ishin themeluar rreth 300 vendbanime, pra Kosovë po tentohej t’i ndryshohej struktura etnike, fetare dhe socio-hapësinore. Kolonëve po ashtu u jepej tokë si aset i mbijetesës, marrja e dhunshme e tokës, ishte edhe mohimi i jetesës për Kosovën agrare të asokohe. Me dështimin e arritjes së objektivave kryesore të procesit të kolonizimit, që ishte duke u kryer nën petkun e reformës agrare, filloi procesi i dëbimit të shqiptarëve. Një mori udhëheqësish dhe akademikëve serbë, vlerësonin se procesi i kolonizimit nuk kishte arritur rezultatet e synuara, dhe se rezultatet gjerë në fillimin e viteve të ’40-ta ishin gjysmake. Një strategji e re kishte ardhur në skenë nga akademiku Vasa Çubriloviç, i cili propozoi zgjidhjen e spastrimit etnik të shqiptarëve, si zgjidhjen më të shpejtë dhe më efikase ndaj problemit të shqiptarëve në Serbi. Shteti i atëhershëm, kishte arritur një marrëveshje fillimisht në vitin 1926, për kthimin e popullsisë turke në Turqi. Nga kjo marrëveshje synohej lëvizja e 300-400,000 njerëzve në drejtim të Turqisë. Ndërsa edhe një marrëveshje tjetër iu shtua këtij projekti në vitin 1937. Më 12 korrik 1938, gazeta turke “Vatan” në një vlerësim të kësaj marrëveshje potenconte se “250,000 emigrantë do të arrinin nga Jugosllavia. Pra, situata gjerë në pragun e Luftës së Dytë Botërore e gjeti Kosovën në një pozicion tejet të vështirë.

### Triumfi i ri, Jugosllavia e vjetër?!

Me triumfin e ideologjisë komuniste në Ballkan, u zhvillua një riformatim i plotë i shteteve dhe i ideologjisë së sundimit në to. Ndonëse Kushtetuta e Jugosllavisë u miratua në vitin 1946, përmbajtja e saj ishte përcaktuar në kuadër të Deklaratës së AVNOJ në vitin 1943, dhe modelit të Kushtetutës Sovjetike. Në kuadër të kësaj Kushtetute, statusi i Kosovës përcaktohet si krahinë autonome brenda Serbisë. Triumfi i komunizmit, kishte sjellë me ideologjinë e tij, moton e famshme të “Vllaznim-Bashkimit”, si një premisë e cila do të rregullonte marrëdhëniet e reja, në shtetin e ri Jugosllavë. Nëse shohim në retrospektivë, gjerë në vitin 1999, statusi shoqëror, politik dhe ekonomik i kosovarëve nuk kishte ndryshuar aq shumë. Modeli ekonomik i decentralizuar në bazë të krahinave vetëm sa kishte thelluar pabarazitë në zhvillim mes republikave dhe krahinave. Shembull në statistikat e viteve të ’80-ta, një qytetarë në Slloveni fitonte 2.4 herë më shumë se një qytetarë në Kosovë, që punonte të njëjtën punë. Përpos zhvillimit ekonomik të ulët në këtë rajon, papunësisë dhe varfërisë së lartë, ideja e normalizimit të marrëdhënieve nën petkun e një shtetit të ri të reformuar dukej të ishte akoma sfidë, pasi që dimensionin kulturor dhe e kaluara historike ndërmjet këtyre popujve dukej që e vështirësonte premisën ideologjike të “Vllaznim-Bashkimit”. Faza e industrializimit ishte vetëm një nga proceset që e ngriu përkohësisht marrëdhënien ndërmjet popujve, të cilat u kthyen në skenën politike e publike të ish-Jugosllavisë si rezultat i pabarazisë ndërmjet popujve. Rrugëtimi i Kosovës drejt lirisë përfshinë një histori të gjatë të aktivizimit social, politik, rezistencës paqësore, rezistencës së armatosur e deri te ri-ndërtimi.

Për nder të 17 vjetorit të pavarësisë së Kosovës, po ju ofrojmë 17 ngjarje nga më të rëndësishmet që sollën avancimin e statusit të Kosovës dhe hapën shtegun e saj deri në pavarësim të plotë.



## 1. DEMONSTRATAT E VITIT 1968

Demonstrata e vitit 1968 kishin filluar për shkak të trajtimit të pabarabartë të shqiptarëve dhe mohimit të të drejtave bazike për arsimim në gjuhën amtare dhe përdorimin e simboleve kombëtare. Ndonëse në këto demonstrata, u shfaqën edhe parullat në kërkim të Republikës, me parullat si: “Duam Republikë”, “Duam vetëvendosje deri në shkëputje” si dhe kërkesat tjera që lidhen me të drejtat bazike si “Duam Barazi”, “Duam universitet”. Përpos mohimit të të drejtave bazike, shkaqet tjera deri te këto demonstrata ishin edhe mungesa e mësimdhënësve të kualifikuar, mos integrimi i duhur i shqiptarëve në administratën e shtetit, përndjekja e shqiptarëve që ishin aktivist. Demonstratat patën disa rezultatet pozitive: Më 17 nëntor të vitit 1968 u lejua përdorimin i flamurit kombëtar shqiptar në Kosovë. Në fund të viteve '60-ta, shqipja filloi të përdorej si gjuhë në institucionet publike, por me përdorim të kufizuar. Ngjarjet e 1968-të ndikuan në themelimin e Universitetit të Prishtinës.

## 3. ZGJERIMI I AUTONOMISË 1974

Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974 i dha Kosovës një autonomi të zgjeruar, duke e barazuar praktikisht me republikat jugosllave. Në këtë kushtetutë, Kosovës nuk iu njoh e drejta për shkëputje. Kosova fiton institucionet si: Kuvendin, Qeverinë, Gjykatën Kushtetuese dhe Supreme, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve. Me këtë kushtetutë, gjuha shqipe u zyrtarizua si gjuhë zyrtare krahas serbo-kroatishtes. Për herë të parë Kosova, kishte përfaqësues të saj në Presidencën Jugosllave dhe organet më të larta të vendit.

## 4. THEMELIMI RADIOTELEVISIONIT TË PRISHTINËS (RTP)

Themelimi i Radiotelevizionit të Prishtinës ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme jo vetëm në fushën e informimit në gjuhën shqipe, por edhe zhvillimit kulturor për shqiptarët e Kosovës. RTP-ja si i vetmi medium me program në gjuhën shqipe, u bë mjet i rëndësishëm për informimin e shqiptarëve. Përpos dimensionit të informimit, ky medium kontribuoi në forcimin e identitetit kombëtar shqiptar në Kosovë dhe u bë platformë e rëndësishme e afirmimit të kulturës kombëtare. Si i vetmi medium, RTP u bë platformë e promovimit të shumë artistëve, krijueseve në Kosovë. Radiotelevizioni mbeti funksional gjerë më 5 korrik 1990, kur forcat serbe mbyllën me dhunë RTP-në dhe larguan me forcë punonjësit e këtij mediumi.

## 2. THEMELIMI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Universiteti i Prishtinës erdhi si rezultat i kërkesës së pareshtur të shqiptarëve për të drejtën e edukimit, e veçmas edukimit të lartë universitar në gjuhën amtare. Ky nivel i edukimi kryhej vetëm në gjuhën serbe, dhe në Kosovë nuk kishte institucion që ofronte edukimin universitar. Themelimi i Universitetit të Prishtinës ishte ngjarje historike për popullin e Kosovës, si edhe për mbarë kombin shqiptar. Kuvendi themelues i Universitetit të Prishtinës u mbajt më 13 shkurt 1970, kurse dy ditë më vonë, më 15 shkurt 1970, u mbajt edhe mbledhja solemne e kuvendit dhe pikërisht kjo datë u shpall Dita e Universitetit të Prishtinës. Ndonëse vendimi ishte miratuar në vitin 1969, nga Kuvendi i Krahinës Socialiste të Kosovës.. Nga viti 1970–1981, Universiteti i Prishtinës kishte thelluar bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës, ku shumë profesor nga Shqipëria ndihmuan në avancimin e profileve dhe zhvillimin e kuadrove të reja, ndër këta profesorë veçohen: Eqrem Çabej, Aleks Buda, Kristo Frashëri, Mahir Domi etj. Në kuadër të rezistencës dhe angazhimit në sistemin paralelë si dhe në kuadër të planeve për të shkatërruar elitën intelektuale të kohës, u vranë profesorët: Fehmi Agani, Ukshin Hoti, Xhemajl Mustafa, Halil Alidema, Haki Ukaj.



## 5. PROTESTAT STUDENTORE TË VITIT 1981

Protestat studentore të periudhës mars-prill, në viti 1981, kishin shpërthyer si rezultat i pabarazisë ekonomike dhe sociale dhe diskriminimit sistematik të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Ankesat e studentëve adresonin mungesën e kushteve në Universitetin e Prishtinës si: konviktet, mensa, burimet akademike, diskriminimi politik dhe ndalimi i diskutimeve rreth çështjes kombëtare shqiptare. Protestat studentore vinin si reflektim i Kushtetutës së vitit 1974. Studentët në Kosovë ishin të pakënaqur me statusin e Kosovës në këtë Kushtetutë, dhe kërkonin republikë me të drejta të plota. Kjo protestë, solli reagim brutal nga shtetit serb, ku u vendos masa e jashtëzakonshme, në këto përleshje u vranë 9 protestues dhe u arrestuan mbi 1400. Kjo solli edhe masa tjera të rrepta në raport me universitetin, ku shumë profesorë u përjashtuan nga Universiteti i Prishtinës. Këto protesta shënuan fillimin e dukshëm të konfliktit politik në mes shqiptarëve dhe serbëve.



## 6. GREVA E MINATORËVE

Greva e Minatorëve filloi si kundërshtim kundër vendimit të Slllobodan Millosheviçit për të tërhequr autonominë e Kosovës dhe vendosjen e kontrollit të plotë të Serbisë mbi krahinën autonome të Kosovës. Greva filloi në muajin shkurt, të vitit 1989, kur minatorët e kombinatit metalurgjik "Trepça", hynë në grevë urie si kundërshti ndaj zhvillimeve politike që kishte nisur Slllobodan Millosheviçi. Ndonëse situata kishte filluar qysh nga viti 1988, ku 2000 minatorë kishin marshuar nga "Trepça" për të mbrojtur autonominë[1]. Në vitin 1989, vlerësohet se mbi 1300 minatorë hynë në grevën 8 ditore që dha një 'tërmet' politik deri në Beograd. Greva e vitit 1989, nxiti protesta gjithëpopullore në Kosovë, si angazhim qytetar për mbrojtjen e autonomisë dhe kundërshtimit të vendimeve që i morri Millosheviçi në vitin 1989.



## 7. SISTEMET PARALELE

Me vendimet politike të Millosheviçit, politikat ndaj shqiptarëve u ashpërsuan edhe më tej. Me fillimin e tentativës së aparatit shtetëror që të vendos kontroll të plotë mbi institucionet e Kosovës, filloj politika diferencuese e Slllobodan Millosheviçit. Sistemet paralele u zhvilluan si rezultat i përjashtimit të shqiptarëve nga institucionet kyçe në Kosovë, dhe kthimit të institucioneve në shërbim vetëm të popullsisë serbe. Politikat e tilla nga Millosheviçi, lirshëm mund të cilësohen si politika të aparteidit. Duke qenë para një realiteti të tillë popullata shqiptare, krijoj një mosbesim dhe një shmangie të institucioneve publike duke krijuar sisteme paralele në shëndetësi, arsim, sport etj. Nga praktikat më të suksesshme, veçohet sistemi paralel arsimor, ku në tërë Kosovën, vlerësohen të kenë qenë afro 3000 shtëpi-shkolla ku është organizuar mësimi paralel. Sistemet paralele në Kosovë zgjatën nga viti 1990 deri më 1999. Sistemi paralel mbetet nga shembujt më të mirë të solidaritetit shoqëror dhe mirëfunksionimit në kushtet të diskriminimit dhe presionit të plotë nga institucionet shtetërore.

## 8. KUSHTETUTA E KAÇANIKUT DHE REPUBLIKA

Procesit të përjashtimit dhe diferencimit nuk i shpëtuan edhe delegatët e ish-Krahinës së Kosovës. Më 2 korrik 1990, deputetët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës shpallën Deklaratën Kushtetuese, duke e shpallur Kosovën njësi të pavarur brenda Federatës Jugosllave. Pas kësaj ngjarje Serbia, shpërndau Kuvendin e Kosovës dhe ktheu këtë territor si të okupuar tërësisht. Si kundërpërgjigje, delegatët shqiptarë u mbledhën me 7 shtator 1990, në qytetin e Kaçanikut duke miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila shpallte Kosovën si një republikë të barabartë me republikat e tjera të Jugosllavisë. Kësisoj në Kosovë, njerëzi filluan të njohin kushtetutshmërinë e kësaj kushtetute të miratuar nga këta delegat. Ky ishte hapi i parë i pavarësisimit dhe i funksionimit të ndarë si institucione dhe politike nga shteti serb.



## 9. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK) DHE LËVIZJA POPULLORE KOSOVËS (LPK)

Më 23 dhjetor 1989 u krijua Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), si një subjekt politik që do të shndërrohej njëkohësisht edhe në një lëvizje të rëndësishme politike. Pikëpamja ideologjike dhe politike e LDK-së ishte pikëpamje demokratike, e cila synonte arritjen e pavarësisimit të Kosovës nëpërmjet mjeteve diplomatike, paqësore. LDK-ja ishte nga mekanizmat kyç në organizimin e jetës politike përgjatë viteve të '90-ta. Nën orkestrimin e LDK-së u organizuan dhe u mbarëvajtë sistemi paralel. Po ashtu në mënyrë të fshehtë, LDK-ja organizoi referendumin e vitit 1991, ku 90% të shqiptarëve të Kosovës votuan për pavarësinë e Kosovës. Gjatë vitit 1992, LDK-ja arriti të krijojë qeverinë (institucionet paralele) me Dr. Ibrahim Rugovën, president, ndërsa Bujar Bukoshin, kryeministër të qeverisë në ekzil (Zvicër).



## 10. DALJA NË SKENË E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

\***Lëvizja Popullore e Kosovës** përbën një tjetër lëvizje sociale e politike që kishte qëndrime më radikale. LPK-ja ishte themeluar që në fillim të viteve të '80-ta. Në viti 1982, filluan të krijohen degë të kësaj lëvizje edhe në shtete të Evropës Perëndimore, me qëllim të mbështetjes së kauzës së saj. Kauza e saj ishte të krijonte në rezistencë të armatosur, si mjet të çlirimit të Kosovës. Prej vitit 1990, LPK-ja kishte arritur të organizonte celulatat e para të UÇK-së në zona të ndryshme të Kosovës.

Nga viti 1995-96, UÇK-ja kishte organizuar disa sulme guerile ndaj forcave policore serbe në Kosovë. Mirëpo ekzistenca, veprimtaria e UÇK-së mbetjet misterioze dhe e paqartë për shumëkë, gjerë në viti 1997, ku më 28 nëntor në Llaushë të Skënderajt, gjatë ceremonisë së varrimit të mësuesit Halit Geci, UÇK-ja bën daljen e parë publike para popullatës, duke shpallur qartazi qëndrimet dhe luftën e saj të hapur ndaj Serbisë. Tri figurat që bën debutimin e UÇK-së ishin: Mujë Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Daut Haradinaj. Nga betejat e para vlen të theksohet beteja 28 shkurtit 1998, në fshatin Likoshan.



## 11. FAMILJA JASHARI, SIMBOLI I REZISTENCËS

Pas ngjarjeve të Likoshanit, ku në vitin 1998, ndodhi ndër masakrat e para ku u vranë 24 civil shqiptarë. Datat 5-7 mars 1998, paraqesin datat më të përgjakshme dhe të cilat paraqesin periudhën fillestare të përshkallëzimit të konfliktit në formë të dukshme. Gjatë datave 5-7 mars 1998, u zhvillua aksioni ndaj familjes Jashari në Prekaz të Skenderajt. Në mëngjes të datës 5 mars, forcat ushtarake dhe policore serbe filluan rrethimin e Kullës së Familjes Jashari. Gjatë sulmeve të pareshtura përgjatë dy ditëve, mbetën të vrarë 58 anëtarë të familjes Jashari dhe disa mysafirëve që ishin në ato momente në kullë. E vetmja që i mbijetoi sulmit ishte Besarta Jashari. Figurat e Adem dhe Hamëz Jasharit ishin bërë simbol i rezistencës të armatosur në tërë Kosovën. Familjarët u varrosën më 11 mars, me iniciativë dhe organizim të banorëve nga fshatrat për rreth dhe me mbështetje nga vende të ndryshme të Kosovës. Ngjarja e familjes Jashari, tregoi qartazi se lufta ishte tashmë ngjarje e pashmangshme.

## 12. MASAKRA E REÇAKUT

Më 15 janar 1999, në Reçak të Shtimës, ndodhi një nga ngjarjet më të rënda dhe aktet më të dukshme të spastrimit etnik në Kosovë. Në këtë datë, forcat serbe vranë 45 civil shqiptarë të paarmatosur. Ngjarja e Reçakut, pati një rëndësi tejet të madhe në zhvillimin e rrjedhës së luftës më tutje. Më 16 janar 1999, ambasadori amerikan William Walker, i cili drejtonte Misionin Verifikues të OSBE-së në Kosovë, vizitoi Reçakun. Deklaratat e ambasadorit amerikan, u bën shkas që shumë shtete të kërkonin ndërhyrjen ushtarake, me qëllim humanitar, të parandalimit të spastrimit etnik në Kosovë.



## 13. NDËRHJRJA E NATO-SË

Pas dështimit të bisedimeve në Rambuje të Francës dhe ngjarjeve makabre që po ndodhnin në Kosovë, opsioni i vetëm në horizont dukej të kishte mbetur ndërhyrja ushtarake. Më datë 24 mars, NATO filloi fushatën e bombardimeve të ish-Jugosllavisë. Ky ishte konflikti i parë në histori ku NATO ndërhyri pa miratimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, por me justifikimin e mbrojtjes së popullsisë civile nga gjenocidi dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Bombardimet e NATO-s, zgjatën për 78 ditë dhe përfunduan me 10 qershor 1999. Ndërhyrja e NATO-s, solli frustrim të shtetit serb, i cili intensifikoi fushatën e spastrimit etnik duke krijuar disa nga masakrat më të mëdha: Mejë (377 viktima), Krushë e Madhe (266 viktimat), Izbicë (147) etj. Përfundimi i bombardimeve të NATO-së, erdhi si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës.

## 14. VENDOSJA E ADMINISTRIMIT NDËRKOMBËTAR

Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit, miratoi Rezolutën 1244, e cila vendosi Kosovën nën administrimin ndërkombëtar të OKB-së (me misionin UNMIK). Programet e OKB-së dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë mundësuan stabilizimin e vendit dhe zhvillimin e programeve humanitare. Këto procese të rëndësishme krijuan kushte për rikthimin në vendbanimet e tyre të shqiptarëve të dëbuar nga Kosova dhe kthimin drejt normalitetit.



## **15. NEGOCIATAT NË VJENË DHE PLANI I AHTISARIT**

Gjatë vitit 2006-2007 u mbajtën një seri bisedimesh të njohura si Negociatat e Vjenës, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje për statusin e Kosovës. Këto negociata u ndërmjetësuan nga diplomati Marti Ahtisari. Pavarësisht nga propozimet nga dy delegacionet, nuk pati një zgjidhje definitive për statusin e Kosovës. Në mars të vitit 2007, Marti Ahtisari, paraqiti propozimin e tij për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Plani i Ahtisarit propozonte pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën dhe prani ndërkombëtare për një periudhë të caktuar. Stabilitetin dhe sigurinë në vend do të garantonte NATO, për një periudhë të pacaktuar. Në këtë pako u përfshinë me theks të veçantë, e drejta e pakicave, ky plan theksonte krijimin e komunave me shumicë serbe përmes procesit të decentralizimit dhe jepte autonomi të zgjeruar për këto komuna. Plani parashihte edhe hapa tjerë të ndërtimit të një identiteti të një shteti multi-etnik.

## **16. SHPALLJA E PAVARËSISË SË KOSOVËS**

Duke qenë se, Negociatat e Vjenës nuk dhanë ndonjë rezultat, autoritetet e Kosovës vendosën të shpallin pavarësinë e Kosovës më 17 shkurt 2008. Shpallja e pavarësisë u bazua në Planin e Ahtisarit dhe me koordinim me aleatët si SHBA-në dhe BE-në. Seancën historike e hapi, Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës e lexoi, kryeministri Hashim Thaçi. Në deklaratën e pavarësisë u potencua orientimi demokratik duke potencuar mbështetjen në Planin e Ahtisarit, pranimin e Rezolutës 1244 dhe duke shprehur mirënjohjen për punën e OKB-së gjerë në pavarësim. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë erdhën njohjet e para vendet si SHBA-ja dhe një pjesë e madhe e vendeve të Bashkimit Evropian.

## **17. VENDIMI I GJYKATËS NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË**

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, shteti serb menjëherë reagoi ndaj këtij akti duke kundërshtuar këtë vendim dhe duke kërkuar nga OKB-ja që të verifikoj ligjshmërinë e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Serbia paraqiti kërkesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për të kërkuar opinionin e Gjykatës mbi legalitetin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në tetor të vitit 2008. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e miratoi kërkesën e Serbisë me 77 vota pro. Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, me 10 vota pro dhe 4 kundër vendosi që akti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk shkelte të drejtën ndërkombëtare duke theksuar se akti i shpalljes së pavarësisë nuk ishte i paligjshmes sipas ligjit ndërkombëtar.

## **BURIME:**

[1] Dokumenti o spoljnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914, knj. VII, sv. 1. Beograd, 1980., str. 617-618.

[2] M. Obradović, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941 (str. 153, 210, 215, 220), Priština 1981.

[3] Ramet, Sabrina P. (2010). Central and Southeast European Politics Since 1989 (në anglisht). Cambridge University Press. f.361

## **FIGURA:**

Foto 1. Demonstratat e vitit 1968, @Telegrafi

Foto 2. Universiteti i Prishtinës, @Klan Kosova

Foto 3. Radio Televizioni i Prishtinës (RTP), @Wikipedia

Foto 4. Demonstratat studentore 1981, @Epoka e Re

Foto 5. Greva e Minatorëve, @Radio Kosova e Lirë

Foto 6. Sistemi Paralel i Arsimit, @Kallxo.com

Foto 7. Kushtetuta e Kaçanikut, @KultPlus

Foto 8. Themelimi i LDK'së, @KultPlus

Foto 9. Dalja në skenë e UÇK'së, @BotaPress

Foto 10. Familja Jashari, Prekaz @Dosja.al

Foto 11. Masakra e Reçakut, @The geopost

Foto 12. NATO në Kosovë, @EuronewsAlbania

Foto 13. OKB, @UNMIK

Foto 14. Shpallja e pavarësisë së Kosovës, 2008, @Gazeta Zëri